

AKT- THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

tre i sh.p.k

Ne Durres, sot më datë 25/022023, ortakët themelues te shoqërisë

tre i shpk:

Z. ENRICO FASSIO, atësia Francesco, i datëlindjes 11/03/1948 , lindur në Itali dhe banues në Romw, Itali, shtetas italian, madhor, dhe me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaportë me numër YB9522150.

dhe

Znj. ALIONA BACIU, atësia Andrei, e datëlindjes 31/03/1975 , lindur në Straseni, Moldavi dhe banuese në Romw Itali, shtetase italiane, madhore, dhe me zotësi juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaportë me numër YA8752123.

Të cilët me cilësinë e “Ortakëve themelues” kërkuan redaktimin e këtij akti themelimi, nëpërmjet të cilit deklaroi se me vullnet të lirë të plotë e të sinqertë, dhe inisiativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “tre i” shpk

KREUI

Neni 1

Krijimi

tre i sh.p.k

Është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në ligj Shoqëria tre i sh.p.k, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga shtetasi Italian **Z. ENRICO FASSIO**, dhe shtetasja Italiane **Znj. ALIONA BACIU**, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.



Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në: Lagja Nr. 1, Rruga Taulantia, Zk. 8512, Seksioni 6, K.4, Ap.2, Durrës. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakëve themelues .

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Realizim i fushatave dhe projekteve reklamuese , identifikimi i produkteve, realizimi dhe testimi i prototipeve, Identifikimi i produkteve, reklamim I tyre ne vazhdimesi. Identifikimi I prodhueseve per pordhimin dhe shitjen me sukses te produktit ne te ardhmen Aktivizimi i fushatave reklamuese dhe crowdfunding, si dhe cdo gje tjeter qe nuk bie ne kundërshtim me ligjin.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

Kapitali

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njeqindë mijë lekë), i cili ndahet në 2 kuota, në raport me kontributin e dhënë nga ortakët në shoqëri ku ortakët zotërojnë kuota të ndarë si më poshte :

Ortaku, Z. ENRICO FASSIO : zoterues i nje kuote të përbërë 50 pjesë me vlerë të përgjithshme 50.000 lekë, që përbëjnë 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ortaku, Znj. ALIONA BACIU: zoteruese i një kuote të përbërë 50 pjesë me vlerë të përgjithshme 50.000 lekë, që përbëjnë 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuota e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata **duhet të bëhet** me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë **përgjigjen në mënyrë** solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Ortakët e shoqërisë janë organi vendimmarrës i shoqërisë. Ortakët e shoqërisë janë organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë

Ortakët vendosin për çështje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;


Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për :

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) Investime;
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i drejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim , përveç rastit kur shoqëria provon se i tretë ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



Neni 9



Administrimi

Administrator i shoqërisë tre i sh.p.k , caktohet Znj. Aliona Baci, e cili emërohet për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtrijje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakëve themelues të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregëtare, të vendosura nga asamblëja e përgjithshme;
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregëtare;
- c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) Përgatisë dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqesin këto dokumenta përpara asamblësë së përgjithshme për miratim
- e) Krijoi një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë siç parashikohet në ligjin për QKR.
- g) Raporto përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë në mbledhjen e Asamblësë në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratorët, së bashku edhe veças njëri-tjetrit, kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtzakonshëm. Administratorët e përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjithë personave fizik e juridik, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratorët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ja jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratorët angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj. Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose për të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11



Viti Financiar

Viti Financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet në 31 dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) me vendim të ortakëve themelues
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) me vendim të Gjykatës

Në këtë rast Asambleja merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 13

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjiit "Për tregtarët dhe Shoqërit tregtare", Kodit Civil dhe çfarë do ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky Akt Themelimi u redaktua në 4 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare Shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.

ORTAKËT THEMELUES

ENRICO FASSIO

ENRICO FASSIO
Enrico Fassio

ALIONA BACIU

Aliona Baciu
Aliona Baciu